

VENDIM
Nr. 502, datë 30.7.2014

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TE BASHKIA LIBRAZHD, E QARKUT TË ELBASANIT, TË SIPËRFAQES 414 M², NË ZONËN KADASTRALE NR. 2446, ME NUMËR PASURIE 7/49, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “b”, 5, 6, shkronja “a”, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Drejtësisë te Bashkia Librazhd, e qarkut të Elbasanit, të pronës së paluajtshme me sipërfaqe 414 (katërqind e katërmëdhjetë) m², në zonën kadastrale nr. 2446, me numër pasurie 7/49, me emërtim “Gjykata e Rrethit Librazhd dhe sipërfaqe funksionale”, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur në funksion të arsimit parashkollor e arsimit bazë.

2. Përfshihet nga transferimi në pronësi të Bashkisë Librazhd ambienti i emërtuar “Arshiva”, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Prona me numër pasurie 7/49, me emërtim “Gjykata e Rrethit Librazhd dhe sipërfaqe funksionale”, sipas kufizimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.


4. Bashkisë Librazhd i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i Bashkisë Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

